**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
  - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Kualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	



**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i shërbimit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					

---

<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

#### **1. Specifikimet teknike**

#### **1 Larja dhe dezinfektimi i koshave dhe tualeteve (WC)**

##### **1.2 Volumet e punimeve**

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë tualetet me sipërfaqe prej 133 m<sup>2</sup>, 2 herë në ditë sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

##### **1.3 Metodologjia**

1. Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë 2 herë në ditë WC dhe koshat si dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre.
2. Tualetet detyrimisht do të lahen në të gjithë sipërfaqen, duke përdorur furçë dhe solucione larëse.
3. Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm koshash rezervë për të zëvendësuar çdo natë koshat e larguar për t'u larë.

##### **1.4 Grafikët e punimeve**

1. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Operatori Ekonomik.

2. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar.

##### **1.5 Rregulla për t'u zbatuar**

- 
1. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i koshave të mbledhjes së mbeturinave urbane, etj.

## **1.6 Mjetet dhe pajisjet**

1. Lëndë dezinfektuese dhe aromatizuese për dezinfektimin e WC.
2. Fshesa, kova, shtupa dhe furçë plastike dhe të tjera, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

## **2. Fshirja e shesheve dhe terminaleve me punëto.**

### **2.1. Volumet e Punimeve**

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar për të gjitha sheshet dhe terminalat një sipërfaqe totale prej 51,508.10m<sup>2</sup> me volumet respektive për secilin prej tyre.

Shërbimi i fshirjes me punëto e shesheve dhe terminaleve do të realizohet me krahë 4 herë në javë nga Operatori i Shërbimit, i cili gjithashtu do të kryejë dhe të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse të parashikuara në metodologji për të gjitha sipërfaqet e përcaktuara që janë parashikuar në listën e shesheve dhe terminaleve me volumet e tyre për shërbimin e fshirjes.

### **2.2. Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i fshirjes me punëto i shesheve dhe terminaleve konsiston në:

**2.2.1.** Fshirjen me fshesë e të gjitha shesheve dhe terminaleve nga punëtorët e Operatorit të Shërbimit.

**2.2.2.** Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat e mbeturinave brenda zonës së kontraktuar.

### **2.3. Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

**a.** Fshirja e shesheve dhe terminaleve do të kryhet sipas grafikut.

**b.** Për pastrimin Shesheve dhe Terminaleve në raste të veçanta Autoriteti Kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëjës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të këtij shërbimi.

**c.** Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të mjeteve për sheshe të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor këto ndryshime.

**d.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilin shesh dhe terminal.
2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

**e.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

**f.** Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë.

## **4 Rregulla për t'u zbatuar**

**a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen sheshe dhe terminale të papastruara apo mbeturina të palarguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik.

---

**b.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

**c.** Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë sheshet dhe terminalat më shumë se një herë pa shpenzime.

**d.** Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

**f.** Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren të gjitha masat paraprake për pajisjen me to të punëtorëve nga ana e Operatorit të Shërbimit.

**g.** Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjenike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

## **5. Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

**a.** Çdo punëtor duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

**b.** Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, kruajtëse, lopata, kazanë dore lëvizëse dhe karroca dore.

## **3. Fshirja e rrugëve me makineri**

### **3.1 Volumet e Punimeve**

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet dhe terminalat për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknologjike fshesë të gjitha sheshet dhe terminalat e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet në një sipërfaqe prej 51,508.10m<sup>2</sup>. Ky shërbim do të kryhet 2 herë në javë, në oraret e përcaktuara në grafik.

### **3.2 Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i fshirjes me makineri i shesheve dhe terminaleve konsiston në:

**a.** Fshirjen me makina teknologjike fshesë të të gjithë shesheve dhe terminaleve, duke mbuluar gjithë sipërfaqen të lirë nga parkimi i mjeteve të përcaktuara në zonën e kontraktuar. Në të gjitha sipërfaqet e lira nga parkimi, të përcaktuara në volumet e shërbimit të fshirjes me makineri, fshirja detyrimisht duhet kryer me makinë teknologjike. Në rast të kundërt, do të konsiderohet i pavlefshëm shërbimi i kryer.

**b.** Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit të fshirjes me krahë pastrojnë çdo lloj mbeturine të mbetur nga procesi teknologjik i fshirjes, në mënyrë që sheshet të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në procesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj.

**c.** Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike. Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknologjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera), Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë të shërbimit me krahë.

### **3.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

**a.** Fshirja e shesheve dhe terminaleve do të bëhet sipas grafikut.

---

**b.** Fshirja me makineri teknologjike do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me qëllim që zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e pastër.

**c.** Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës së kontraktuar, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti Kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të mjeteve për sheshe të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor këto ndryshime.

**d.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë:

1. Oraret e operimit në secilin shesh dhe terminal.

2. Llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.

**e.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

**f.** Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, përdorimin e makinave teknologjike, rregullave dhe cilësisë së kërkuar.

### **3.4 Rregulla për tu zbatuar**

**a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen sheshe të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to (rërë, xham, letër, gurë, shishe, materiale organike). Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik.

**b.** Do të konsiderohet e pavlefshme fshirja me makineri teknologjike për fshirjen e shesheve dhe terminaleve, kur kjo e fundit gjatë procesit të punës operon me shpejtësi më të madhe se 3 km/orë.

**c.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, shoferëve dhe pajisjeve për fshirjen e rrugëve.

**d.** Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë sheshet dhe terminalet më shumë se një herë pa shpenzime.

**e.** Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes në sheshe dhe terminale, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

### **3.5 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me makineri të shesheve dhe terminaleve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

**a.** Makina teknologjike për fshirjen e shesheve dhe terminaleve, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës.

**b.** Makineritë teknologjike që do përdoren për shërbimin e fshirjes duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve sipas ofertës dhe në përputhje me këtë dhe të jenë konform normave teknike të Komunitetit Europian.

#### **Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

**a.** Të gjitha automjetet të cilat duhet të përdoren nga operatori i shërbimit për fshirjen e shesheve dhe terminaleve, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti Kontraktor për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.



- 
- b.** Çdo makineri për fshirjen e shesheve dhe terminaleve duhet të lahet dhe pastrohet në fillim ose në fund të itinerarit ditor dhe duhet të jetë e pajisur me një sistem pompimi uji i cili shërben për mbrojtjen nga pluhuri.
  - c.** Një listë e makinave fshirëse do t'i paraqitet Autoritetit Kontraktor përpara fillimit të veprimtarisë së fshirjes.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Sasia e shërbimit per 1 dite
1	Fshirja dhe pastrim me punetore shesh parkimi (4 here ne jave )	m2	51,509	51,509
2	Fshirja e rrugeve me makineri (2 here ne jave)	m2	51,509	51,509
3	Larja e siperfaqeve (1 here ne jave)	m2	51,509	51,509
4	Larja e WC (2 here ne dite)	m2	133	265
5	Larja e siperfaqeve me makineri me pompa presioni heqje e mbetjeve cakcakiza ngjitese shenja gomash ( 1 here ne 3 muaj)	m2	32,129	32,129
6	Pastrim kanale dhe tubacione ne larteesi, me pompa vakumi per thithje dhe pompa presioni per zhblokime ( 1 here ne 6 muaj)	ml	1,788	1,788

#### Afatet e ekzekutimit:

**18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër**

## Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Pastrimi i shesheve të parkimit nën administrimin e Tirana Parking

Detyrat:

#### Shërbime të Pastrimit

Shpërndarja:

Sipas kërkesave të AK.

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

TIRANA PARKING					
TABELA E TE DHENAVE TE SHESHEVE TE ADMINIS TRUARA NGA TIRANA PARKING					
Nr	Emertimi i Sheshit	Siperfaqe parkimi ne	Siperfaqe tualete ne m2	Kabina sherbimi	Nr.Kosha ne cope
1	Asllan Rusi	8076	21	2	8
2	Parkim Qyteti Studenti	6633	21	2	12
3	Parkim Selman Stermasi	2200	0	1	6
4	Parkim Nentoksor Sheshi Skenderbej kuota -6.12 m	6044	65	1	15
5	Parkim Nentoksor Sheshi Skenderbej kuota -3.12 m	2098	0	0	6
6	Parkim Nentoksor Ish Sracioni I Trenit kuota -3.63 m	5376	0	1	8
7	Parkim Nentoksor Ish Sracioni I Trenit kuota -7.00 m	5376	0	1	8
8	Sheshi Avni Rustemi	602	0	1	3
9	Sheshi tek Diga e Liqenit	1425	0	1	2
10	Parkimi Nentoksor 7 Xhuxhat tek rruga e Elbasanit	4890	15	1	0
11	Shesh Parkimi prane Sheshit Italia (tek Arena)	5644	6.4	1	-
12	Shesh parkimi prane Kopshtit Zoologjik	2700.1	-	-	-
13	Sheshi tek Garda	444			
	<b>Shuma Totale</b>	<b>51508.10</b>	<b>128.40</b>	<b>12.00</b>	<b>68.00</b>

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

---

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**Plotesohet me permbushjen e kriterëve të Pergjithshme.**

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.

**2.2.2** Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

---

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2023 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisive të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë. Ky kriter plotesohet me paraqitjen e vetëdeklarimit në fazën e ofertimit.

Shënim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

---

---

### 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Shërbime të një natyre të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë tre viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

*Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- Kur shërbimi i një natyre të ngjashme është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë me vërtetime të lëshuara nga ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Kur shërbimi i një natyre të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur, faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2. Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit Inxhinier Mjedisi për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij:

- 1 (një) Inxhinier Mjedisi i cili të jete i pajisur me Diplome

*Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatores Ekonomike duhet të paraqesin diplome, kontratat e punës (te vlefshme brenda afatit të vlefshmerisë së ofertes) ose kontratë shërbimi e cila të jete e vlefshme për gjithë periudhën e kontratës objekt prokurimi, CV përkatëse, librezë e punës.*

**Shënim:** Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

3. Një punësim mesatar i të paktën 40 personave, për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën 3 (tre) muajt e fundit.
- List pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohe nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit.

**Shënim:** Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

4. Përveç inxhinierit të siperpermendur, duhet të rezultoj i punësuar me kontrata pune ose kontrata shërbimi të vlefshme për gjithë periudhën e marrëveshjes kuadër personeli teknik i domosdoshëm për kryerjen e punimeve: 1 (një) Automakinista të cilët duhet të jene të pajisur me deshmi e aftësi profesionale ose leje manovrimi (te vlefshme) të leshuar nga institucionet e autorizuar me ligj. *(Në rastin kur punonjësit Automakinista janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

**Shënim:** Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

5. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 9001 – 2015** ose ekuivalent, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 14001 – 2015** ose ekuivalent, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 45001-2018** ose ekuivalent, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme)

**Shënim:** *Certifikatat e mesiperme duhet të jene të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkohen duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.*

6. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit (e vlefshme):

- a. Liçense e leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) grumbullim dhe transportim të mbejtjeve urbane të leshuar nga QKL (**Kodi III.2.B**).
- b. Licencën DDD me kod II.8.B të lëshuar nga QKL

**7. Kandidati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:**

Lista e makinerive që duhet të disponojë operatori ekonomik të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Lloji i pajisjeve	Njësia	Sasia	Pronesi/Qera
1	Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 2 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6;	copë	1	Pronesi/Qera
2	Makinë teknologjike e vogël për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës deri në 1 ton, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës.	copë	1	Pronesi/Qera

3	Makinë vetëshkarkuese, me hapje të spondit anësor ose nga pas, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve gjatë ditës, me kapacitet mbajtes 1.5-2 ton.	copë	1	Pronesi/Qera
4	Makineri pompe speciale per larje dysHEMEJE	copë	1	Pronesi/Qera
5	Makineri speciale per fshirjen e pllakave	copë	1	Pronesi/Qera
6	Automjet me agregat teknologjik për pastrimin e kanaleve dhe tubacioneve me lartesi jo me shume se 2.25 m e pajisur me pompe vakumi per thithje dhe pompe presioni per zhbllokime dhe larje tubacionesh	copë	1	Pronesi/Qera
7	Makineri fshesa korenti per sipërfaqet e brendshme (tek parkimet nentokesore)	copë	4	Pronesi/Qera

Shënim: Për Makineritë dhe Mjetet teknologjike të kërkuara më sipër, duhet të- paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

- Mjetet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie original ose kopje te noterizuar (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi).
- Mjetet me qira shoqerohen me kontrate qiraje si dhe me aktin e pronesise se qiradhenesit (original ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerese te permbaje objektin dhe afatin e marrjes me qera te mjeteve ( e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi).
- Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe foto.
- Per mjetet me qera, duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik ,siguracionin e mjetit,(te vlefshme) dhe foto duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre

*Automjet me agregat teknologjik për pastrimin e kanaleve dhe tubacioneve me lartesi jo me shume se 2.25 m e pajisur me pompe vakumi per thithje dhe pompe presioni per zhbllokime dhe larje tubacionesh*

*Pompat duhet te jene te shoqeruara me katalog dhe foto*

**Shënim:** Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9.Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.



---

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.  
Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta,  
konsiderohen kushte për skualifikim.**

